



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 7619 Prot

Vau Dejës, me 26 . 12 .2024

Lënda: Kërkese për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Të nderuar këshilltare,

Bashkelidhur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për "Shtesën e transfertës së pakushtëzuar të Bashkisë Vau Dejës, sipas aktit normative nr 5 datë 19.12.2024, për Bashkine Vau Dejës"

Duke ju uruar pune të mbarë!

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Date _____

Nr. i faqeve A4 te projekt vendimit: 3

Nr. i faqeve A4 te relacionit shoqerues: 3

Nr. i fleteve te dokumenteve qe shoqerojne projekt-vendimin: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 16, datë 26.12.2024

PËR

“SHITESËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR TË BASHKISË VAU DEJËS,

SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 5 DATE 19.12.2024

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit Plotësues nr 1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Sipas Akit Normativ nr 5 , datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar ,sipas shkresës nr 17526/2 datë 23.12.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 5 datë 19.12.2024 ” dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,

V E N D O S I:


1. Të miratojë shpërndarjen e shtesës së transfertës së pakushtëzuar të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë shpërndarjen e shtesës së transfertës së pakushtëzuar të bashkisë, të parashikuar sipas programeve buxhetore, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI





Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr. 1: " Shpërndarje e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2024"
Sipas Aktit Normativ nr 5 date 19.12.2024

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04960	6040000	3333		23,034,504.00	
SHUMA TOTALE										
									23,034,504.00	

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	01110	6023100	3333	9999999	249,128.50	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03140	6023100	3333	9999999	82,507.00	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	6023100	3333	9999999	213,408.00	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04520	6023100	3333	9999999	185,793.50	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	06260	6023100	3333	9999999	304,499.50	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04240	6023100	3333	9999999	1,062,915.00	Blerje karburant për vitin 2024
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04130	6021004	3333	9999999	73,378.00	TVSH për shpenzime operative për bashkefinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion turistik"
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04130	6024100	3333	9999999	6,820.00	TVSH për shpenzime operative për bashkefinancim në projektin "Vau Dejës si një destinacion turistik"
157 00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04520	2310000	3333	1570824	20,856,054.50	Sistemim ,asfaltim rrugët e brendshme Stajkë +Mbikqyrje +Kolaudim
SHUMA TOTALE										
									23,034,504.00	

Nëpunësi Zbatues
Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues
Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU I DEJES

DREJTORIA EKONOMIKE

SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCES

RELACION FINANCIAR

PËR

PROJEKT VENDIMIN

MBI

“SHITESËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR TË BASHKISË
VAU I DEJËS”

SIPAS AKTIT NORMATIV NR 05 DATE 19.12.2024

I. QELLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QE SYNOHEN TE ARRIHEN

Ky projekt vendim ka per qëllim permiresimin e Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 91 date 21.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2024-2026, numrin e punonjesve te Bashkise Vau Dejes" te konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkrese nr 2/1 prot date 09.01.2024.

✓ Në transferten e pakushtezuar:

Duke u bazuar ne *Aktin Normativ nr 5, date 19.12.2024 "Per disa Ndryshime dhe Shtesa ne Ligjin nr 97/2023, "Per Buxhetin e vitit 2024", te ndryshuar, ne nenin nr 8 "Kjo transferte, ne radhe të pare te perdoret per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura dhe, pasi të jene shlyer keto detyrime, perdoret per shpenzime te tjera"* kemi pare te arsyeshme të merret projekt vendimi mbi shperndarjen e ketyre fondeve sipas relacionit si me poshtë:

Detyrimet e Bashkise Vau Dejes deri me date 26.12.2024 jane ne vlerën **65.397.727** lekë, te rakorduara me Degen e Thesarit Shkoder.

Nga keto detyrime vlere prej **57,300,537** lekë jane detyrime me fonde te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (min 06) ne objektin "Ndertim i vendepozitimit per mbetjet urbane Bushat (vazhdimi i fazes II)" , vlere prej **360,119** leke me fonde të Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë (min 10) per objektin "Permiresim i kushteve te banimit per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara (rikonstruksion),vlere prej **695,773** leke me fonde Transferte e Pakushtezuar (min 00) për objektin "Mbikqyrje punimesh" në

objektin "Projekte për përmirsimin e infrastrukturës në zona informale" dhe vlera prej **1,519,988.50** leke me fonde Transferte e Pakushtezuar (min 00) për objektin "Blerje Karburant për vitin 2024"

Po ashtu vlera **3,342,860** lekë, me fonde Transferte e Pakushtezuar sipas VKB Nr. 103, Date 30.12.2023, janë vendime gjyqsore dhe janë në proces gjykimi dhe nuk kemi vendime të formës së prerë ose vendime të ndonjë forme tjetër që ben të mundur shlyerjen e këtyre detyrimeve, të cilat i paraqesim në mënyrë me të detajuar si më poshtë:

1. Kerkese padi nr 115 dt 19.11.2015(lek bibaj),vendim nr 5324 dt 01.10.2014 (gjykata administrative e shkalles pare tirane),vendim nr, 1110(4781) dt 12/10/2018) në vlerën **1,230,000** leke.
2. Vendim nr, 9723 rep 1731 kol 30.05.2013, DHIMITER PAPA në vlerën **2,112,860** leke.

Sa ju perket detyrimeve me fonde të Bashkisë Vau Dejes, ato janë në vlerën **2,178,449.50** lekë, të detajuara si vijon:

- 1- Vlera prej 2,098,251.50 leke për objektin "Blerje Karburant për vitin 2024".
- 2- Vlera prej 80,198.00 leke për TVSH-te për shpenzimet operative për bashkefinansim në projektin "Vau Dejës si një destinacion turistik".

Fondi shtese në transferencën e pakushtezuar të përgjithshme, në favor të Bashkisë Vau-Dejes, në vlerën **23,034,504 lekë** do të përdoret për mbulimin e detyrimeve që Bashkia ka me fonde të veta, në vlerën **2,178,449.50 lekë** mesiper, ndërsa diferenca prej **20,856,054.50 lekë** e shtesës së transferencës së pakushtezuar do të shpërndahet në programin 04520 të rrjetit rrugor rural, për Projektin "Sistemim, asfaltim rrugor dhe brendshme Stajkë+Mbikqyrje +Kolaudim" në llogarinë ekonomike 231.

Nepermjet projektvendimit synohet parashikimi për një buxhet ambicioz, duke çuar në mirëfunksionimin e administratës vendore, duke synuar nivelin e shërbimeve publike, të jemi në mbështetje të bizneseve për të rritur nivelin e duhur të përmirësimit të infrastrukturës së tyre, dhe në fokus të jenë investimet në infrastrukturë dhe shërbimet publike për vitin 2022 është sfida.

Procesi i rishikimit të buxhetit ka qenë i kujdeshëm, i studiuar dhe i mirëmenduar se ku do të mbështetet Bashkia për të përballuar çdo situatë të mundshme. Mënyra e financimit të shërbimeve publike në nivel vendor është nën zbatimin e ligjit nr. 68, date 27.04.2018 "Për financat e veteqverisjes vendore. Projekt vendimi vijon të mbështetë politikën e ndërmarrë nga pushteti vendor, e kryesuar nga vëmendja për ruajtjen e nivelit ekonomik vendor, dhe nepermjet saj përmirësimit të cilësive të shërbimeve ndaj qytetarit, dhe vijueshmërinë e investimeve kapitale në shërbimet publike dhe në infrastrukturë.

II. VLERESIMI I PROJEKTVENDIMIT NE RAPORT ME PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026, DHE ME BUXHETIN E VITIT 2024.

Projekt Vendimi është parashikuar duke u bazuar në politikën dhe strategjinë e programit të PBA-se 2024-2026 dhe me Buxhetin e vitit 2024

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT LIDHUR ME PERPARESITE, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Perparesia e ketij projektvendimi eshte permiresimi i sherbimit te ofruar nepermjet planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe i mire-analizuar i shpenzimeve publike me synim rritjen e efektivitetit dhe perdorimit ekonomik te fondeve publike;

- Menaxhimi efektiv i te ardhurave totale te bashkise si nje menyre e rendesishme per te rritur investimet dhe ne interesin publik;
- Rritje e cilesise se infrastruktures ne territorin e bashkise
- Konsolidimi i sherbimeve publike:
- Nxitje e zhvillimit ekonomik per bizneset:
- Ndërtimi i infrastrukturës moderne:Infrastruktura rrugore,arsimore parauniversitare.

IV. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDERKOMBETAR

Ky projektvendim eshte ne harmoni te plote me ligjin nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar,

Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore,

Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar,

Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 30.07.2018

"Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV";

Udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit",

Ligji 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024" ,

Udhezimit Plotesues nr 01 date 24.01.2024 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024",

Aktit Normativ nr 5 date 19.12.2024 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024",

Shkreses nr 17526/2 date 23.12.2024 "Mbi Zbatimin e Aktit Normativ nr.5 date 19.12.2024" derguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Konceptoi:


Elsa Tanushi



KRYETAR

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 17526/2 prot.

Tiranë, më 23/12 .2024

Lënda: Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024

DEGËS SË THESARIT _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

BASHKISË Vau Dejës

Në zbatim të Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, ju dërgojmë detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme, sipas tabelës bashkëlidhur, në lekë. Ju bëjmë me dije se, kjo transfertë në radhë të parë përdoret për shlyrjen e detyrimeve të prapambetuara dhe pasi të jenë shlyer detyrimet përdoret për shpenzime të tjera. Kjo transfertë nuk përdoret për shpenzimet e rindërtimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja



Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024".

në lekë

Ent. Qev.	Min.Linj.	Kodi Inst.	Emër Inst.	Kap	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Thesarit	TOTALI
SHTESË								
152	00	2152001	Bashkia Belsh	01	04960	6040000	0808	12,609,885
102	00	2102001	Bashkia Berat	01	04960	6040000	0202	32,192,166
103	00	2103001	Bashkia Bulqizë	01	04960	6040000	0603	27,002,783
110	00	2110001	Bashkia Cërrik	01	04960	6040000	0808	15,371,418
104	00	2104001	Bashkia Delvine	01	04960	6040000	3704	6,695,021
105	00	2105001	Bashkia Devoll	01	04960	6040000	1505	19,798,783
106	00	2106001	Bashkia Dibër	01	04960	6040000	0606	42,371,903
147	00	2147001	Bashkia Divjakë	01	04960	6040000	0922	21,786,448
452	00	2452001	Bashkia Dropull	01	04960	6040000	1111	8,225,202
107	00	2107001	Bashkia Durrës	01	04960	6040000	0707	93,286,848
109	00	2109001	Bashkia Elbasan	01	04960	6040000	0808	73,856,957
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	04960	6040000	0909	64,518,732
326	00	2326001	Bashkia Finiq	01	04960	6040000	3704	12,354,220
155	00	2155001	Bashkia F-Arrez	01	04960	6040000	3330	7,992,841
115	00	2115001	Bashkia Gjirokastrë	01	04960	6040000	1111	22,001,244
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	01	04960	6040000	0810	22,080,820
117	00	2117001	Bashkia Has	01	04960	6040000	1812	14,782,748
160	00	2160001	Bashkia Himarë	01	04960	6040000	3737	12,300,174
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	01	04960	6040000	3535	54,997,324
118	00	2118001	Bashkia Kavajë	01	04960	6040000	3513	23,383,505
154	00	2154001	Bashkia Këlcyrë	01	04960	6040000	1128	6,397,822
654	00	2654001	Bashkia Klos	01	04960	6040000	0625	14,284,836
120	00	2120001	Bashkia Kolonjë	01	04960	6040000	1514	12,325,350
156	00	2156001	Bashkia Konispol	01	04960	6040000	3731	6,349,649
122	00	2122001	Bashkia Korçë	01	04960	6040000	1515	46,094,759
123	00	2123001	Bashkia Krujë	01	04960	6040000	0716	30,503,606
124	00	2124001	Bashkia Kuçovë	01	04960	6040000	0217	17,439,810
125	00	2125001	Bashkia Kukës	01	04960	6040000	1818	32,984,154
126	00	2126001	Bashkia Kurbini	01	04960	6040000	2019	24,315,143
127	00	2127001	Bashkia Lezhë	01	04960	6040000	2020	35,386,517
116	00	2116001	Bashkia Libohovë	01	04960	6040000	1111	4,222,502
128	00	2128001	Bashkia Librazhd	01	04960	6040000	0821	28,394,320
129	00	2129001	Bashkia Lushnjë	01	04960	6040000	0922	43,651,137
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	04960	6040000	3323	30,052,750
168	00	2168001	Bashkia Maliq	01	04960	6040000	1515	30,851,078
131	00	2131001	Bashkia Mallakastër	01	04960	6040000	0924	16,183,752
132	00	2132001	Bashkia Mat	01	04960	6040000	0625	19,250,830
143	00	2143001	Bashkia Memaliaj	01	04960	6040000	1134	10,632,803
133	00	2133001	Bashkia Mirditë	01	04960	6040000	2026	20,446,623
112	00	2112001	Bashkia Patos	01	04960	6040000	0909	13,239,070
134	00	2134001	Bashkia Peqin	01	04960	6040000	0827	13,910,920
135	00	2135001	Bashkia Përmet	01	04960	6040000	1128	12,043,653
136	00	2136001	Bashkia Pogradec	01	04960	6040000	1529	37,201,845
140	00	2140001	Bashkia Poliçan	01	04960	6040000	0232	10,072,643
153	00	2153001	Bashkia Prenjas	01	04960	6040000	0821	17,868,323
137	00	2137001	Bashkia Pukë	01	04960	6040000	3330	11,343,817
499	00	2499001	Bashkia Pustec	01	04960	6040000	1515	3,581,905
113	00	2113001	Bashkia Roskovec	01	04960	6040000	0909	11,403,491
119	00	2119001	Bashkia Rrogozhinë	01	04960	6040000	3513	15,088,787
138	00	2138001	Bashkia Sarandë	01	04960	6040000	3731	13,865,796
159	00	2159001	Bashkia Selenicë	01	04960	6040000	3737	17,619,196
108	00	2108001	Bashkia Shijak	01	04960	6040000	0707	15,082,595
141	00	2141001	Bashkia Shkodër	01	04960	6040000	3333	68,819,838
139	00	2139001	Bashkia Skrapar	01	04960	6040000	0232	12,573,325
142	00	2142001	Bashkia Tepelenë	01	04960	6040000	1134	8,833,551
101	00	2101001	Bashkia Tiranë	01	04960	6040000	3535	0
145	00	2145001	Bashkia Tropojë	01	04960	6040000	1836	21,006,794
167	00	2167001	Bashkia Dimal	01	04960	6040000	0202	14,085,812
157	00	2157001	Bashkia V.Dejës	01	04960	6040000	3333	23,034,504
146	00	2146001	Bashkia Vlorë	01	04960	6040000	3737	58,604,046
165	00	2165001	Bashkia Vorë	01	04960	6040000	3535	13,343,623
Total								1,430,000,000